

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6910
E enjte, 1 qershor 2023
Çmimi 0.40 €

Pirja e duhanit,
kërcënim për shëndetin
publik në Kosovë | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PËRFAQËSUESIT NDËRKOMBËTARË, TË SHQETËSUAR PËR SITUATËN NË VERI, KËRKOJNË ZGJIDHJE URGJENTE PËRMES DIALOGUT | FAQE 4-5



Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, ka thënë të mërkurën se autoritetet e Kosovës "mbajnë përgjegjësi për trazirat të cilat janë rritur ndjeshëm" në veri. Në kuadër të Konferencës për Siguri Globale në

Bratisllavë të Sllovakisë, kryeministri Albin Kurti ka takuar Josep Borrellin dhe Miroslav Lajçakun nga të cilët ka marrë mesazhe se situata aktuale në veri është e rrezikshme dhe ata kanë kërkuar zgjidhje urgjente përmes

dialogut. Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, në deklaratën e tij ka thënë se veprimet në veri janë marrë "në kundërshtim me këshillat e Shteteve të Bashkuara dhe partnerëve evropianë të Kosovës"

'PRISHJA'
E RAPORTEVE
ME SHBA-në,
OPOZITA PO
MENDON NISJEN
E NJË MOCIONI
TË MOSBESIMIT
TË QEVERISË
KURTI | FAQE 3



RAFUNA TAKON
VARHELYIN NË
BRUKSEL: KOMPANITË E
RAJONIT DUAN TË JENË
MË TË PRANISHME
NË TREGUN E BE-së | FAQE 7



AKTUALE



SHBA-ja THOTË SE
"KA ARDHUR KOHA" QË SUEDIA
TË ANËTARËSOHET NË NATO | F. 2

VETËVENDOSJA PRISH
KOALICIONIN ME PDK-në
NË GJILAN | F. 6

HAXHIU RAPORTON PARA ANË-
TARËVE TË KOMISIONIT PËR
INTEGRIME EVROPIANE PËR
REFORMAT NË DREJTËSI | F. 7

EKONOMI



NË MUAJIN PRILL, TË PUNËSUAR
ME PAGË PRIMARE NË KOSOVË,
360 446 PERSONA | F. 8

BORDI I AKP-së MERR DISA
VENDIME PËR PROCESIN
E PRIVATIZIMIT | F. 8

SPORT



'DARDANËT' NË PRIZREN I PRESIN
ZVICRËN DHE DANIMARKËN | F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

ShBA-ja thotë se “ka ardhur koha” që Suedia të anëtarësohet në NATO

UASHINGTON, 31 MAJ - Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, ka thënë se “ka ardhur koha” që Turqia të heqë dorë nga kundërshtimet e saj ndaj anëtarësimit të Suedisë në NATO, dhe tha se administrata e Bidenit beson se Turqisë duhet t'i sigurohen avionë luftarakë F-16 “sa më shpejt të jetë e mundur”. Gjithashtu, Blinkeni tha se administrata nuk i konsideron dy çështjet si të lidhura me njëra-tjetrën, por pranoi se disa ligjvënës amerikanë e shohin ashtu.

Të hënën presidenti Joe Biden i lidhi tërthorazi këto dy çështje gjatë një bisede telefonike me presidentin turk Rexhep Tajip Erdogan. “Kam folur me Erdoganin dhe ai ende dëshiron të punojë për diçka për F-16. I thashë se ne duam një marrëveshje me Suedinë. Pra, le ta bëjmë një gjë të tillë”, tha Biden.

Pavarësisht kësaj, Blinken

këmbënguli se dy çështjet ishin të ndryshme. Megjithatë, ai theksoi se përmbushja e të dyjave do të forconte në mënyrë dramatike sigurinë evropiane. “Të dyja këto janë jetike, sipas gjykimit tonë, për sigurinë evropiane”, u tha Blinken gazetarëve në një konferencë të përbashkët shtypi në qytetin verior suedez të Lulea me kryeministrin suedez Ulf Kristersson. “Ne besojmë se të dyja duhet të shkojnë përpara sa më shpejt që të jetë e mundur; do të thotë pranimi i Suedisë dhe ecja përpara në paketën F-16 më gjerësisht”. “Ne besojmë se koha është tani”, tha Blinken.

Ai nuk pranoi të parashikonte se kur Turqia dhe Hungaria, i vetmi anëtar tjetër i NATO-s që nuk e ka ratifikuar ende anëtarësimin e Suedisë, do të jepnin miratimin e tyre.

Por, tha ai, “ne nuk kemi asnjë dyshim se mund të, duhet të, dhe ne presim që të bëhet” deri në kohën kur liderët e aleancës



takohen në Vilnius, Lituani në korrik në një samit vjetor.

I sapo dalë nga një fitore e fortë e rizgjedhjeve gjatë fundjavës, Erdogan mund të jetë i gatshëm të zbusë kundërshtimet e tij ndaj anëtarësimit të Suedisë.

Erdogan akuzon Suedinë se nuk ka reaguar ndaj grupeve që

Ankaraja i konsideron si terroriste dhe një seri protestash për djegien e Kuranit në Stokholm zemëruan bazën e tij mbështetëse fetare - duke e bërë qëndrimin e tij të ashpër kundër Suedisë edhe më popullor.

Kristersson tha se të dy palët kishin qenë në kontakt që nga

votimi i së dielës dhe nuk shprehu asnjë hezitim për të folur për përfitimet që Suedia do t'i sjellë NATO-s “kur të bashkohemi me aleancën”.

Blinken është në Suedi për të marrë pjesë në një takim të Këshillit të Tregtisë dhe Teknologjisë ShBA-BE dhe do të udhëtojë në Oslo të Norvegjisë të mërkurën për një mbledhje të ministrave të Jashtëm të NATO-s, përpara se të shkojë në Finlandë, anëtarin e sapo pranuar të aleancës, të premten.

Duke folur në Oslo përpara takimit të ministrave të Jashtëm, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg tha se qëllimi është që Suedia të bëhet pjesë e Aleancës përpara samitit të liderëve në korrik. “Nuk ka garanci, por është absolutisht e mundur të arrihet një zgjidhje dhe të mundësohet vendimi për anëtarësimin e plotë të Suedisë deri në samitin e Vilniusit”, ka theksuar Stoltenberg.

Dështon lëshimi i satelitit të Koresë së Veriut, raketa bie në det

SEUL, 31 MAJ - Përprerja e Koresë së Veriut për ta vendosur satelitin e parë spiun të vendit në hapësirë dështoi të mërkurën. Ky dështim shihet si një pengesë ndaj ambicieve të liderit Kim Jong Un për t'i rritur aftësitë e tij ushtarake në kohën kur tensionet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Korenë e Jugut po rriten. Pas pranimit jashtëzakonisht të shpejtë të dështimit të tyre, Koreja e Veriut shprehu synimin e saj për të vazhduar një lëshim të dytë, duke synuar t'i korrigjojë problemet e hasura gjatë ngritjes fillestare të raketës.

Kjo deklaratë nënkupton se Kim Jong Un mbetet i vendosur në përprjekjet e tij për ta zgjeruar armatimin e vendit dhe për të ushtruar presion shtesë si ndaj Uashingtonit ashtu edhe ndaj Seulit, veçanërisht në një

periudhë ku negociatat diplomatike kanë ngecur.

Koreja e Jugut dhe Japonia u kërkuan shkurtimisht banorëve të strehohen gjatë nisjes së satelitit.

Sipas ushtrisë së Koresë së Jugut, aktualisht po bëhen përprjekje për të rikuperuar një objekt që besohet të jetë një fragment i raketës së rrëzuar koreano-veriore. Ministria e Mbrojtjes shpërndau fotografi të një cilindri të bardhë, metalik, duke e identifikuar atë si një përbërës të dyshuar të raketës.

Sipas vëzhguesve, një lëshim satelitor nga Koreja e Veriut shkel rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, të cilat e ndalojnë vendin të angazhohet në çdo lëshim duke përdorur teknologji balistike.

Pavarësisht dështimit të lëshimit,

megjithatë, përprerja “flet për përmirësimin e vazhdueshëm të aftësive të Koresë së Veriut, duke mprehur programin e saj të raketave dhe armëve bërthamore”, tha Eleanor Shiori Hughes, një anëtare jorzidente në institutin e mendimit Econvue me bazë në Çikago.

Megjithëse Shtetet e Bashkuara, Koreja e Jugut dhe Perëndimi kanë dënuar lëshimet e automjeteve hapësinore të Veriut për përdorimin e teknologjisë së raketave balistike, Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara do të luftojë për ta trajtuar çështjen nën një front të bashkuar mes ndarjeve për luftën e vazhdueshme në Ukrainë, tha Hughes.

Hughes tha se ishte e rëndësishme që Japonia ta përmirësonte sistemin e saj të



emergjencës “J-Alert” pas paralajmërimeve të gabuara pas lëshimeve të fundit të raketave të Koresë së Veriut, duke shtuar se sistemi mund të jetë i nevojshëm një ditë për zhvillime të

mundshme që lidhen me Kinën. Pheniani tha se do ta hetojë shkakun e dështimit dhe do të synojë për një lëshim të dytë sa më shpejt të jetë e mundur, pa specifikuar një datë.

IAEA: Ukraina dhe Rusia të shmangin katastrofën bërthamore në Zaporizhja



GJENEVE, 31 MAJ - Shefi i mbikëqyrjes bërthamore të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Rafael Grossi, i ka kërkuar Ukrainës dhe Rusisë t'u përmbahen pesë parimeve për ta parandaluar katastrofën bërthamore në termocentralin bërthamor të Zaporizhjas në Ukrainë.

Në një konferencë për sigurinë e termocentralit bërthamor, i cili ka qenë shkak për

shqetësim qëkur forcat ruse morën kontrollin e tij pas pushtimit në shkurt të vitit 2022, Rafael Grossi, drejtor i përgjithshëm i Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike (IAEA), i prezantoi parimet para Këshillit të Sigurimit të OKB-së në Nju-Jork më 30 maj. “Situata e sigurisë bërthamore dhe e sigurisë në termocentralin e Zaporizhjas... vazhdon të jetë

jashtëzakonisht e brishtë dhe e rrezikshme. Aktivitetet ushtarake vazhdojnë në rajon dhe mund të rriten shumë në mënyrë të konsiderueshme në të ardhmen e afërt”, tha ai në një referencë të dukshme ndaj një kundëroffensive të pritshme të Ukrainës.

Në fjalimin e tij në Këshillin e Sigurimit, Grossi theksoi domosdoshmërinë e shmangies së çdo forme sulmi që synon termocentralin.

'Prishja' e raporteve me ShBA-në, opozita po mendon nisjen e një mocioni të mosbesimit të qeverisë Kurti

EPOKA
ERE

Lirim GEÇI

PRISHINË, 31 MAJ - Partitë opozitare në vend kanë reaguar pas vendimit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës për t'i ndërprerë stërvitjet e përbashkëta ushtarake "Defender Europe 2023" dhe deklaratës së ambasadorit amerikan në Prishtinë, Jeffrey Hovenier, se ShBA-ja po shqyrton edhe masa të tjera dhe se, aktualisht, "nuk ka entuziazëm" për ta ndihmuar Kosovën në përpjekjet e saj për të fituar njohje më të madhe ndërkombëtare ose për të përparuar drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe në NATO.

Kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, në një konferencë për medie mbajtur të mërkurën, ka theksuar se sot nuk është një ditë e zakonshme në vend e as një javë e zakonshme. "Që prej të premtes po ballafaqohemi me një situatë të pamenduar e të paparë për një kohë të gjatë - Kosova nën sulm të vazhdueshëm nga bandat kriminale të Vuçiqit, e kryeministri i Kosovës në sulm fatkeq ndaj miqve tanë ndërkombëtarë. Kjo nuk i kishte ngjarë ndonjëherë Kosovës. Sa herë kemi qenë të sulmuar nga Serbia, kemi qenë të mbrojtur nga miqtë amerikanë dhe aleatët evropianë. Sepse kemi qenë të bashkërenduar me ta. Sepse kemi vepruar bashkë me ta, sepse kemi ndarë të njëjtat vlera, të njëjtat interesa e të njëjtin vizion", ka theksuar Abdixhiku, duke shtuar se këtë përmbysje aleancash, vizioni e prioritetesh për Republikën e Kosovës, askush nuk e ka dashur. "Për këtë përmbysje askush nuk ka votuar. Prandaj këtu nuk mund të flasin për tjetër gjë përveçse për një aventurë tejet të rrezikshme personale të Kurtit e cila nuk ka asnjë pikë legjitimiteti politik e demokratik. Sepse shkatërrimi i aleancës me miqtë tanë as nuk ka përputhje me vullnetin politik të popullit të Kosovës, vullnet ky historikisht pro-perëndimor, as nuk është në interes të popullit të Kosovës strategjikisht të lidhura me aleancën perëndimore e tejqeoanike", ka deklaruar ai.

Abdixhiku ka thënë se kjo situatë duhet kuptuar drejt nga miqtë tanë perëndimorë. "Sulmet ndaj Republikës së Kosovës sot janë sulme ndaj paqes rajonale. Për këtë paqe rajonale, për rëndësinë e saj, ne ndajmë qëndrimet me miqtë tanë ndërkombëtarë", ka thënë ai.

Lideri i LDK-së ka thënë se Kurti ka vendosur kinse që ta mbrojë Kosovën nga Amerika. "Ne jemi të vendosur ta mbrojmë Kosovën nga dëmet që Kurti po ia shkakton interesit nacional të Kosovës. Kurti ka vendosur të luftojë kundër aleatëve tanë, për qëllime politike, për pak vota më shumë. Ne jemi të vendosur të luftojmë bashkë me ta



për Kosovën. Dhe kjo luftë kërkon maturi diplomatike, bashkërendim me miqtë ndërkombëtarë dhe insistim në mbrojtjen e interesit të Kosovës. Por një prej interesave jetike të Kosovës ka qenë dhe mbetet miqësia me Amerikën dhe BE-në. Nuk mund të mbrohet Kosova kur cenohet ky interes", ka deklaruar Abdixhiku.

Edhe Partia Demokratike e Kosovës është e shqetësuar me zhvillimet e fundit që e kanë sjellë Kosovën në përballje të rrezikshme me aleatët tanë, veçanërisht me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhe kërkon nga Qeveria e Republikës së Kosovës që ta rimendojë dhe ta ndryshojë urgjentisht qasjen e saj.

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, në mbledhjen e Kryesisë së PDK-së, u shpreh i shqetësuar me zhvillimet e fundit në vend dhe me drejtimin e përgjithshëm që ka marrë Kosova nën drejtimin e kryeministrit Albin Kurti. "Kryesia e Partisë Demokratike të Kosovës shpreh zhgënjimin e thellë për veprimet e pakoordinuara të Qeverisë së Kosovës me aleatët strategjikë të vendit tonë, që tashmë kanë filluar të rezultojnë me ndëshkime të drejtpërdrejta, pasi Kosova u përjashtua nga stërvitja më e madhe ndërkombëtare e NATO-s në rajonin e Ballkanit, 'Defender Europe 2023'. Ky përjashtim është shenjë konkrete e përkeqësimit të raporteve të Kosovës me ShBA-në dhe NATO-s dhe është paralajmërim për pasojat të tjera, nëse Qeveria e Republikës së Kosovës nuk fillon të sillen në mënyrë të përgjegjshme. Po ashtu, kryesia e Partisë Demokratike të Kosovës e dënon fuqishëm dhunën e grupeve kriminale të drejtuar kundër pjesëtarëve të KFOR-it, por edhe Policisë së Kosovës, dhe veçanërisht kundër

përfaqësuesve të medieve, të cilët janë penguar dhe sulmuar gjatë kryerjes së detyrës së tyre në shërbim të informimit të qytetarëve", thuhet në komunikatën e PDK-së.

Anëtarët e kryesisë shprehën mbështetje të plotë për kryetarët e komunave të Zubin Potokut dhe Zveçanit që vijnë nga radhët e PDK-së, të cilët me përgjegjshmëri kanë treguar gatishmëri për t'u shërbyer të gjithë qytetarëve, pa dallim, por edhe bëjnë thirrje për rikthimin e normalitetit për të mundësuar zbatimin e mandateve të tyre. "Edhe një herë, duke pasur parasysh peshën dhe kompleksitetin e situatës si dhe tensionet e ngritura në pjesën veriore të vendit, kryesia e Partisë Demokratike të Kosovës u bënë thirrje presidentes dhe kryeministrit që ta mbledhin urgjentisht Këshillin e Sigurisë së Kosovës. Kryesia e Partisë Demokratike të Kosovës vlerëson se situata e krijuar kërkon qasje të përgjegjshme të institucioneve të Kosovës e jo veprime populiste të momentit që mund të sjellin pasojat afatgjatë për të ardhmen e vendit", është bërë me dije në komunikatën e PDK-së.

Pas mbledhjes së kryesisë së Kuvendit, para medieve shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka paraqitur qëndrimet e kësaj partie lidhur me situatën aktuale në veri të Kosovës. Ai ka thënë se Kuvendi i Kosovës, partitë politike, institucionet e Kosovës nuk mund të sillen kinse nuk është duke ndodhur asgjë në këtë vend. Sipas tij, gjendja është e jashtëzakonshme dhe për rrjedhojë "nuk mund të silleni zakonshëm". "Për AAK-në është shumë me rëndësi që të nisë një mocion i mosbesimit të qeverisë Kurti, për arsytet si: Me qasjen e Qeverisë dhe kryeministrit Kurti, Kosova po vazhdon me shpejtësi ta humb sovranitetin e saj në Veri

të Kosovës. Nga marrja e vendimit për targa, Kosova në atë pjesë të vendit është vetëm duke u dobësuar dhe duke e humbur sovranitetin. Me këtë qasje, na solli në situatë, ku KFOR-i dislokoi trupa shtesë në Veri të Kosovës, bazuar në Rezolutën 1244. Në fakt, ky dislokim po ndodhë 15 vjet pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Qeveria Kurti na solli në një situatë me aleatin më të madh - ShBA-në - garantuesin e sovranitetit e shtetësisë dhe pavarësisë së vendit tonë, të na vendosin sanksione. Sanksione të cilat e kanë goditur në themel funksionimin e shtetit, duke larguar Kosovën nga Defender Europë 2023, e deri te masat tjera të cilat pritet të ndodhin", ka thënë Tahiri.

Ai ka theksuar se nuk ka logjikë, në kohën kur aleati ynë kryesor e ka problemin më të madh të sigurisë në luftën në Ukrainë, t'ia hapim edhe një problem tjetër të sigurisë në Ballkanin Perëndimor me veriun e Kosovës. "Për AAK-në institucionet janë të shenjta, as kriminelët e Vuçiqit, e as policët me uniforma e pa uniforma, nuk do të mund asnjëherë ta sfidojnë shtetin e Kosovës. Shteti e shtëpia mbahen me miq, e mik më të mirë se sa Amerika, populli i Kosovës nuk ka. Albin Kurti e LV-ja duhet t'i hapin sytë mirë dhe të mendojnë se ku jemi sot. AAK-ja është ajo që e ka mbështetur marrëveshjen finale me Serbinë, që nga dita e parë, i ka qëndruar në krah në të gjitha betejat që i ka pasur me Serbinë si për zgjedhjet, referendumin, e çështje tjera. Ne, nuk mund t'i japim mbështetje një kryeministri, i cili na solli në një situatë që ShBA-ja të na vë sanksione. Këtë shtet dhe këtë liri e kemi fituar falë luftës së generatave deri te UÇK-ja, në bashkërendim dhe partneritet me Amerikën dhe NATO-në. E dimë që ky komunikim me ShBA-në është përgjegjësi politike,


shtetërore e institucionale dhe e kemi obligim t'i tregojmë Qeverisë Kurti, që kjo është rrugë qorre", ka thënë ai.

Një ditë më parë, ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, tha se Qeveria e Kosovës nuk është koordinuar me Shtetet e Bashkuara për veprimet e ndërmarrja në veri dhe, për këtë arsye, ka pësuar pasojën e parë: "stërvitjet 'Defender Europe 2023' kanë marrë fund për të".

Hovenier i bëri komentet në një takim me një grup gazetarësh në Prishtinë. Ai iu referua vendimit të Qeverisë së Kosovës për t'i instaluar me forcë kryetarët shqiptarë të komunave me shumicë serbe në veri të vendit - Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq - përkundër rezistencës së vazhdueshme të banorëve lokalë, që rezultoi në dhunë. "Kur kemi marrë vesh, kemi reaguar ashpër kundër. Vendimi [i qeverisë] ka pasur ndikim negativ në reputacionin e Kosovës dhe i ka kthyer mbrapsht përpjekjet për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë", ka theksuar Hovenier.

Ai citoi sekretarin amerikan të Shtetit, Antony Blinken, i cili paralajmëroi se këto veprime do të ndikojnë në marrëdhëniet ShBA - Kosovë dhe tha se anulimi i pjesëmarrjes së Kosovës në stërvitjet "Defender Europe 2023" është pasojë e parë për Qeverinë e Kosovës në këtë drejtim.

Që nga 26 maji në veri të Kosovës janë rritur tensionet, pasi po atë ditë, kërret e rinj të Zveçanit, Leposaviqit dhe Zubin Potokut, u futën në ndërtesat komunale nën përcjelljen e Policisë së Kosovës. Bashkësia ndërkombëtare ka dënuar ashpër "hyrjen me forcë" të kryetarëve të rinj komunalë dhe ka kërkuar nga autoritetet e Kosovës ta shtensionojnë menjëherë situatën.



Përfaqësuesit ndërkombëtarë, të shqetësuar për situatën në veri, kërkojnë zgjidhje urgjente përmes dialogut

Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, ka thënë të mërkurën se autoritetet e Kosovës “mbajnë përgjegjësi për trazirat të cilat janë rritur ndjeshëm” në veri. Në kuadër të Konferencës për Siguri Globale në Bratisllavë të Sllovakisë, kryeministri Albin Kurti ka takuar Josep Borrellin dhe Miroslav Lajçakun nga të cilët ka marrë mesazhe se situata aktuale në veri është e rrezikshme dhe ata kanë kërkuar zgjidhje urgjente përmes dialogut. Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, në deklaratën e tij ka thënë se veprimet në veri janë marrë “në kundërshtim me këshillat e Shteteve të Bashkuara dhe partnerëve evropianë të Kosovës”

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHINË, 31 MAJ - Qytetarët serbë që po kundërshtojnë kryetarët shqiptarë të komunave me shumicë serbe në veri të Kosovës kanë protestuar për të tretën ditë me radhë. Një grup serbësh në Zveçan mëngjesin e së mërkurës kanë shpalosur një flamur të gjatë të Serbisë para ndërtesës komunale atje kundër kryetarit të ri shqiptar.

Të njëjtin mëngjes pjesëtarët e misionit paqeruajtës të NATO-s në Kosovë, KFOR, vendosën tela me gjemba. Situata të mërkurën në

veri ka qenë e qetë, ndërsa të pranishëm në këtë pjesë kanë qenë edhe ushtarët amerikanë të KFOR-it.

Policia e Kosovës ka bërë me dije se në bashkëpunim me KFOR-in dhe institucionet relevante po vazhdon angazhimet policore për zbatimin e rendit dhe sigurisë publike, ofrimin e sigurisë ndaj qytetarëve, sigurimin e lirisë së lëvizjes së lirë si dhe ndërmarrjen e masave policore konform situatës dhe zhvillimeve në komunën Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok.

Përfaqësuesit ndërkombëtarë janë shprehur të shqetësuar për

situatën në veri.

Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, ka thënë se autoritetet e Kosovës “mbajnë përgjegjësi për trazirat të cilat janë rritur ndjeshëm” në veri të Kosovës prej se kryetarët e rinj shqiptarë morën detyrën në komunat me shumicë serbe.

Macron i bëri komentet në një konferencë për sigurinë në Bratisllavë.

Qëndrimi i presidentit francez është në bashkërendim me deklaratat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe vendeve të tjera të Quint-it të cilat e bënë Qeverinë e Kosovës fajtores për tensionimin e





situatës në veri të vendit.

Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, në deklaratën e tij ka thënë se i dënon fuqishëm veprimet e Qeverisë së Kosovës, të cilat, sipas tij, po e përshkallëzojnë tensionet në veri dhe po shtojnë jostabilitetin. Ai ka thënë se këto veprime janë marrë “në kundërshtim me këshillat e Shteteve të Bashkuara dhe partnerëve evropianë të Kosovës”. Edhe shefi i diplomacisë së Bashkimit Evropian, Josep Borrell, ka thënë se Kosova duhet t’i pezullojë operacionet e policisë rreth ndërtesave komunale në veri të shtetit, si “hap i parë për uljen e tensioneve, ndërsa protestuesit e dhunshëm të ndalen”. “Dua të them se BE-ja e dënon fuqishëm dhunën në veri të Kosovës që kemi parë ditët e fundit. Aktet e dhunës ndaj qytetarëve, medieve, forcave të rendit dhe KFOR-it janë të papranueshme. Ne si BE qëndrojmë prapa NATO-s dhe KFOR-it për përmbushjen e mandatit në interes të paqes dhe stabilitetit në Kosovë”, ka theksuar Borrell.

ShBA-ja ndërmori masa kundër Kosovës për injorimin e këshillave të saj për ta shmangur rritjen e tensioneve në zonën veriore me shumicë serbe. Ajo e kritikoi Qeverinë e Kosovës për instalimin e kryetarëve shqiptarë në veri “me mjete të dhunshme”. Për pasojë, Kosova u përjashtua nga pjesëmarrja në një stërvitje ushtarake, të udhëhequr nga Amerika në Evropë.

Ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeffrey Hovenier, ka

theksuar se ShBA-ja po shqyrton edhe masa të tjera dhe se, aktualisht, “nuk ka entuziazëm” për ta ndihmuar Kosovën në përpjekjet e saj për të fituar njohje më të madhe ndërkombëtare ose për të përparuar drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe në NATO. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se është i brengosur për masat që ka ndërmarrë ShBA-ja kundër Kosovës për shkak të situatës në veri të vendit, por “asnjëherë i frikësuar”.

ShBA-ja ka thënë se Kosova i injoroi këshillat e saj për ta shmangur rritjen e tensioneve në veriun e banuar me shumicë serbe dhe e përjashtoi atë nga pjesëmarrja në një stërvitje ushtarake, të udhëhequr nga Amerika në Evropë. “Po punojmë shumë që të gjejmë një zgjidhje për këtë”, ka theksuar Kurti të mërkurën gjatë

një adresimi nga Bratislava, ku po merr pjesë në një forum për sigurinë.

Kurti ka thënë se nuk mund t’i urdhërojë kryetarët e rinj shqiptarë të komunave me shumicë serbe në veri të Kosovës, të kalojnë në zyra të tjera, jashtë objekteve komunale.

Një gjë e tillë është kërkesë e protestuesve serbë që i kundërshtojnë kryetarët shqiptarë, por edhe e komunitetit ndërkombëtar, i cili thotë se ky veprim do t’i ulte tensionet. “Nëse tani do t’i urdhëroja kryetarët të kalonin në zyra të tjera, do t’i binte sikur po angazhohem për rikrijimin e strukturave paralele ndaj strukturave paralele”, ka pohuar Kurti, duke iu referuar strukturave paralele serbe që veprojnë në veri të Kosovës që nga paslufta. “Unë nuk mund të ulem në zyrë si



AShAK-u: Serbia mbetet faktor destabilizues në Ballkan

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (AShAK) ka shprehur brengën për situatën e krijuar në veri të vendit duke thënë se ajo është rezultat i “politikave pro-ruse që ndjek mbështetësi dhe frymëzuesi i bandave kriminale, Beogradi zyrtar dhe presidenti [Aleksandar] Vuçiq”.

AShAK-u thotë se është e domosdoshme që institucionet e Kosovës t’i përballojnë

situatat e rrezikshme “në bashkëpunim dhe bashkërendim me aleatët”, për të mirën e qytetarëve të Kosovës dhe të paqes e të sigurisë në rajon. “Ne e mbështetim fuqishëm aleancën e popullit të Kosovës me Perëndimin dhe aleatët e saj natyrorë, të përcaktuar për anën e drejtë të historisë”, thuhet në komunikatën e AShAK-ut.

AShAK-u, po ashtu, iu kundërpërgjigj deklaratave të një dite më parë të bëra nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Serbisë (SANU), të cilët i bënë thirrje komunitetit ndërkombëtar që “sa më shpejt të ndërmarrë hapa për të garantuar të drejtat themelore demokratike dhe njerëzore të popullit serb” në Kosovë, si dhe për ta “siguruar paqen, sigurinë dhe jetën normale për të gjithë

njerëzit që jetojnë atje”. Bordi Ekzekutiv i SANU-së të martën e 30 majit tha se “ata të cilëve u është besuar nga Kombet e Bashkuara të kujdesen në mënyrë të paanshme për paqen e të gjithë qytetarëve në Kosovë kanë marrë pjesë në dhunën ndaj qytetarëve të kombësisë serbe”. “Me këtë rast shprehim keqardhjen tonë të thellë që Akademia Serbe e Shkencave

dhe e Arteve (SANU), hartuese e ‘Memorandumit’ dhe ideatore e ‘botës serbe’, paraqitet sërish në publik me deklaratat e saj të zakonshme nacionaliste, duke e nxitur konfliktin dhe duke i quajtur zhvillimet në veriun e Kosovës dhe sulmet e bandave kriminale serbe mbi ushtarët e KFOR-it si ‘dhunë mbi popullin serb’”, theksohet në komunikatën e AShAK-ut.

Kurti takon Borrellin dhe Lajçakun: Situata aktuale në veri është e rrezikshme

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, është takuar me përfaqësuesin e Lartë të Bashkimit Evropian, Josep Borrell, dhe të dërguarin e BE-së për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Miroslav Lajçak, gjatë vizitës së tij të mërkurën në Bratislavë të Sllovakisë.

Takimi ka ndodhur para pjesëmarrjes së Kurtit në një diskutim për të ardhmen e Kosovës në kuadër të Konferencës për Siguri Globale në Bratislavë. Pas takimit, Borrelli bëri thirrje përmes llogarisë së tij në “Twitter” për

“de-përshkallëzimin urgjent dhe një zgjidhje përmes dialogut për t’iu rikthyer punës sonë për zbatimin e marrëveshjes së arritur”.

Ai e quajti situatën aktuale në veri të Kosovës “të rrezikshme dhe të paqëndrueshme”. “Situata aktuale (në veri) është e rrezikshme dhe e paqëndrueshme. Ne kemi nevojë për de-përshkallëzimin urgjent dhe një zgjidhje përmes dialogut për t’iu rikthyer punës sonë për zbatimin e marrëveshjes së arritur”, ka shkruar Borrelli.

kryeministër dhe t’u them kryetarëve në veri: ju nuk duhet të qëndroni në objektet e komunës. Unë e di se mund të qëndrojnë shumë më shkurt sesa që është mandati i tyre, ata janë teknikë, administrativë”, ka thënë Kurti.

Reagimet ndërkombëtare erdhën pas aksioneve të Policisë së Kosovës, më 26 maj, në tri komunat në veri të Kosovës, Zubin Potok, Zveçan dhe Leposaviq, për të siguruar qasje në objektet komunale të kryetarëve të ri të këtyre tri komunave.

Përshkallëzimi në veri kulmoi të hënën, më 29 maj, kur trupat paqeruajtëse të KFOR-it ndërhyjnë në Zveçan “për t’i shmangur përplasjet mes palëve dhe për ta minimizuar rrezikun e përshkallëzimit”, dhe u sulmuan nga disa protestues të dhunshëm, që Qeveria e Kosovës thotë se ishin

“banda kriminale serbe”.

Nga kjo përlëshje që ndodhi, 30 ushtarë të KFOR-it u lënduan.

Shefi i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka bërë me dije se aleanca verit-atlantike do ta rrisë për 700 numrin e trupave në Kosovë në kuadër të misionit të saj, KFOR.

“Ne kemi vendosur t’i angazhojmë 700 trupa shtesë nga Forca Operacionale Rezervë për Ballkanin Perëndimor, dhe që të ngremë në nivel të lartë gatishmërinë e një batalioni shtesë të forcave rezervë, ashtu që ata të mund të angazhohen, nëse do të ketë nevojë”, ka thënë ai.

Kryetarët e rinj shqiptarë të komunave Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq kanë dalë nga zgjedhjet e jashtëzakonshme të 23 prillit, të cilat janë bojkotuar nga komuniteti serb.

'Dita Botërore Kundër Duhanit', mbahet aktivitet me qytetarë për rreziqet e duhanit



DRENAS, 31 MAJ - Edhe në komunën e Drenasit është shënuar 31 maji 'Dita Botërore Kundër Duhanit'. Komuna e Drenasit, përkatësisht Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, në koordinim me QKMF-në në

me qytetarë në sheshin "Fehmi e Xhevë Lladrovci", ku për qëllim kishte rritjen dhe ndërgjegjësimin publik si dhe promovimin e stilit të shëndetshëm të jetesës. Dita Kundër Duhanit synon t'i informojë njerëzit për rreziqet e duhanit, t'i inkurajojë

njerëzit që kanë zakonin e duhanpirjes të marrin vendimin për ta ndaluar atë. Është e rëndësishme, po ashtu, të theksohet se duhanpirja është një zakon i rrezikshëm që ka pasoja të këqija për shëndetin dhe është shkaktar i shumë sëmundjeve.

Vetëvendosje prish koalicionin me PDK-në në Gjilan

GJILAN, 31 MAJ - Lëvizja Vetëvendosje dhe Partia Demokratike e Kosovës e kanë prishur bashkëpunimin për qeverisje në komunën e Gjilanit. Lajmin e ka dhënë kryetari i kësaj komune, Alban Hysni. Ai ka thënë se pas dështimit të seancës për të tretën herë me radhë, qeverisja e përbashkët me PDK-në në Gjilan ka marrë fund. "Kundërligjshmërinë dhe padrejtësinë e luftojmë, pa kompromis. Pas dështimit të seancës për të tretën herë me radhë, qeverisja e përbashkët me PDK-në në Gjilan ka marrë

fund. Janë tri vendime, pas të cilave, të ngjashme presim të vijmë ende për votim, që po bëhen shkaktarë për ndërprerjen e bashkëpunimit. Vendimet e konstatuara si të kundërligjshme, si dhe që favorizojnë individë e grupe të interesit, janë tema që nuk diskutohen, por anulohen, pa alternativë. Ne vazhdojmë të jemi të prerë në qëndrimet dhe parimet tona. Pavarësisht pengesave dhe barrierave të shumta nga shumë akterë, askush dhe asgjë nuk devijon misionin tonë", ka shkruar Hyseni në "Facebook".



Hapet ekspozita e profesor Nefi Rexhepit në Galerinë e Arteve në Podujevë



PODUJEVË, 31 MAJ - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, bashkë me nënkryetaren e komunës, Marigona Lahu, drejtorin e drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Pajtim Balaj dhe disa pjesëtarë të tjerë komunalë, kanë vizituar ekspozitën personale të profesor Nefi Rexhepit e cila është hapur në Galerinë e Arteve në Podujevë.

Kryetari Bulliqi tha se "ishte kënaqësi e veçantë për të parë karikaturat e profesorit që ishin shumë kreative dhe paraqisnin një botë tërësisht tjetër, ku autori përmes punimeve të tij e pasqyron realitetin, e që na bënë secilin të reflektojmë në jetën tonë të përditshme për ta ndryshuar atë".

Karikaturat e profesor Rexhepit kanë paraqitur dhe reflektuar problemet e shoqërisë përmes linjave, ngjyrave dhe humorit të tyre.

Kryetari Bulliqi i ftoi të gjithë artdashësit e artit pamor t'i shohin nga afër punimet e profesorit Nefi Rexhepi. Ekspozita do të qëndrojë e hapur deri të shtunën.

Pas gjashtë javësh përfunduar vizitat sistematike të 6 800 nxënësve në 52 shkolla të Prizrenit

PRIZREN, 31 MAJ - Pas gjashtë javësh intensive kanë përfunduar vizitat sistematike të 6 800 nxënësve në 52 shkolla të menaxhuara nga Drejtoria Komunale e Arsimit në tri shkolla private

dhe në dy shkolla speciale të komunës së Prizrenit. Kryetari Shaqir Totaj ka shprehur mirënjohje për punën e jashtëzakonshme të ekipeve profesionale shëndetësore dhe personelit

të arsimit.

Raporti nga ky aksion, i organizuar nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Arsimit, do të dalë së shpejti me rekomandimet dhe gjetjet e këtij procesi.



Pirja e duhanit, kërcënim për shëndetin publik në Kosovë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 31 MAJ - Me moton "Ne kemi nevojë për ushqim, jo për duhan", në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike (IKShP) është shënuar Dita Botërore pa Duhan.

Drejtori i Institutit Kombëtar, Naser Ramadani, ka thënë se duhani është kërcënim për shëndetin publik në Kosovë, andaj duhet të ulet niveli i konsumimit të tij. Ai ka thënë se këtë vit fushata për Ditën Botërore Pa Duhan u bënë thirrje qeverive dhe politikëbërësve që të zhvillojnë politika dhe strategji të përshtatshme dhe t'i përkrahin fermerët për rritjen e kulturave ushqimore dhe jo të duhanit sepse, sipas tij, në këtë mënyrë do t'u siguronin atyre dhe familjeve të tyre një jetë më të mirë.

"Rezultatet e hulumtimit STEPS 2019 treguan se 25.7 për qind e të anketuarve të rritur, në Kosovë përdorin duhan (35.3 për qind meshkuj dhe 15.9 për qind femra), 23.2 për qind e tyre kanë përdorë duhan në baza ditore (32.3 për qind meshkuj kundrejt 13.9 për qind femra). Nga krahasimi i rezultateve të

STEPS 2019 në raport me rezultatet e STEPS 2011 del se kemi tendencë të zvogëlimit të përdorimit të duhanit, pasi që në vitin 2011, 28.4 për qind e të anketuarve në Kosovë përdornin duhan (37.4 për qind meshkuj dhe 19.7 për qind femra), dhe 25.6 për qind kanë përdorur duhanin në baza ditore (35.2 për qind meshkuj dhe 16.3 për qind femra)", ka theksuar Ramadani.

Zëvendësministrja e Shëndetësisë, Dafina Gexha, ka thënë se para dhjetë vjetësh Kosova miratoi Ligjin për Kontrollin e Duhanit, me qëllimin kryesor që të mbrohet shëndeti i popullatës, me theks të veçantë që të mbrohen gjeneratat e reja. Por, sipas saj, ndërhyrjet e vazhdueshme të industrisë dhe kompanive të duhanit, përkrahja politike e diskutueshme për zbatimin e ligjit dhe kapacitetet e kufizuar mbikëqyrëse, ndikuan në uljen e nivelit të zbatimit të ligjit duke kufizuar efektet pozitive të ligjit. "Me qëllim të forcimit të zbatimit dhe monitorimit të ligjit, ditë më parë Qeveria e Kosovës formoi Këshillin Ndërmëtor për Kontrollin e Duhanit; jemi duke ndërtuar një plan të monitorimit të Ligjit për



Kontrollin e Duhanit; do të miratojmë dhe implementojmë së shpejti edhe Udhëzimin Administrativ për Vërejtjet e kombinuara shëndetësore dhe do të mbajmë përgjegjës për zbatim të ligjit të gjitha institucionet që kanë mandate ta zbatojnë ligjin", ka pohuar ajo. Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, ka shprehur vullnetin dhe gatishmërinë për vazhdimin e aksionit për respektimin e ligjit dhe parandalimin e pirjes së duhanit në ambiente të mbyllura. Ai ka theksuar se MBPZhr-ja, respektivisht AUV-

i, përmes inspektoratit tani e disa muaj ka dinamizuar kontrollet e pirjes së duhanit në hapësira publike. Për një periudhë prej fare pak muajsh, sipas tij, janë inspektuar mbi 4 000 inspektime dhe janë shqiptuar 535 gjoja.

Shefi i Zyrës së OBSH-së në Kosovë, Oleksandr Martynenko, ka dhënë disa mesazhe kyçe lidhur me Ditën Botërore pa Duhan. Ai ka theksuar se një person çdo katër sekonda vdes nga duhani. Gjithashtu, Martynenko tha se përdorimi i cigareve elektronike, çamçakëzëve me nikotinë - të

gjitha dëmtojnë shëndetin. Ndërsa bëri thirrje për zbatim më të rreptë të politikave dhe rregulloreve për ndalimin e duhanit në hapësira publike. Arben Lila nga Qendra për Zhvillim dhe Avokim në Kosovë (KADC) ka theksuar se prindërit në Kosovë janë të shqetësuar lidhur me fushatën agresive të rekrutimit të fëmijëve nga industria e duhanit, për duhanpirjen përmes e-cigareve dhe 'vaping'. Po ashtu, ai ka thënë se duhet të ndalohen rreptësisht reklamat në emisione televizive dhe në radio të këtyre produkteve.

Haxhiu raporton para anëtarëve të Komisionit për Integritet Evropian për reformat në drejtësi

PRISHTINË, 31 MAJ - Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka raportuar të mërkurën para anëtarëve të Komisionit Parlamentar për Integritet Evropian lidhur me reformat në fushën e drejtësisë dhe përbashkëtimin e veprimeve të ministrisë sipas Agjendës për Reformë Evropiane dhe Programit për Zbatimin e MSA-së.

Ministrja Haxhiu ka shprehur keqardhjen për mungesën e opozitës në Komision derisa po raportonte për çështjet, siç tha, të rëndësishme që kanë të bëjnë me reformën evropiane.

Në fjalën e saj, ministrja Haxhiu



tha se për vitet 2021, 2022 dhe 2023, Ministria e Drejtësisë ka pasur gjithsej 35 masa dhe obligime sipas Programit

Kombëtar për Zbatimin e MSA-së, që disa prej tyre janë edhe pjesë e ERA 2 - Agjendës për Reformë Evropiane. "Nga

obligimet e tilla, më lejoni t'ju informoj se 26 masa janë zbatuar tërësisht, prej të cilave 4 masat e parapara për vitin 2023 janë duke u zbatuar sipas afatit", ka thënë Haxhiu.

Në kuadër të reformave kyçe, ministrja Haxhiu ka thënë se Ministria e Drejtësisë ka hartuar Strategjinë për Sundimin e Ligjit e cila për vitin 2022 arrin zbatimin në 88 për qind si dhe janë paraparë ndryshimet kushtetuese për vetingun, ndryshime këto që do ta përmirësojnë qasjen në drejtësi. Po ashtu, ministrja Haxhiu si pjesë të reformës në drejtësi përmendi edhe nënshkrimin e Deklaratës së

Përbashkët të Zotimit mes në Ministrisë së Drejtësisë dhe aktorëve kyç të sistemit të drejtësisë, Projektligjin për Byronë Shtetërore dhe për Verifikimin e Pasurisë së Pajustificueshme si dhe tri ligje të tjera që kanë të bëjnë me sistemin prokurorial.

Më tutje, para anëtarëve të Komisionit, ministrja Haxhiu foli edhe për hartimin e legjislacionit që ka sjellë reforma në fushën penale dhe civile, në fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar, në adresimin e krimeve të luftës, në fushën e drejtësisë administrative dhe të punës si dhe në luftën kundër dhunës në familje.

Rafuna takon Varhelyin në Bruksel: Kompanitë e rajonit duan të jenë më të pranishme në tregun e BE-së

Bruksel, 31 maj - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, në cilësinë e kryetarit të Bordit Menaxhues të Forumit Investues të Ballkanit Perëndimor, është pritur në takim nga komisionari për Fqinjësi dhe Zgjerim i BE-së, Oliver Varhelyi, me të cilin ka biseduar për shtimin e bashkëpunimit ekonomik në mes të Ballkanit Perëndimor dhe BE-së.

Rafuna ka theksuar se takimi me komisionarin Varhelyi ishte mundësi e mirë për ta theksuar nevojën për bashkëpunim në mes të bizneseve të Ballkanit Perëndimor me ato të BE-në dhe se kompanitë e rajonit duan të jenë më të pranishme në tregun e BE-së. "Ne kemi marrë mbështetje të plotë dhe shumë pozitive nga komisionari jo vetëm për Dhomat e Tregtisë të Ballkanit Perëndimor, por edhe për

sektorin privat, në mënyrë që të gjitha marrëveshjet e nënshkruara të zbatohen plotësisht dhe sektori privat të përfitojë sa më shumë", u shpreh kryetari Rafuna.

Në këtë takim Rafuna ishte i shoqëruar nga zëvendës-kryetari i Bordit Menaxhues të Forumit Investues të Ballkanit Perëndimor, në të njëjtën kohë edhe kryetar i Odës Ekonomike të Serbisë, Marko Cadez.



BQE-ja paralajmëron bankat e Eurozonës nëse fondet e tyre kanë probleme

PRISHTINË, 31 MAJ - Bankat kryesore të Eurozonës mund të goditen nëse klientët e tyre financiarë tërheqin depozitat e tyre ose përballen me probleme, paralajmëron Banka Qendrore Evropiane. BQE-ja ka shqyrtuar rrezikun e përhapjes nga të ashtuquajturat banka hije, si fondet dhe kompanitë e tjera financiare që ofrojnë fonde në forma të ndryshme të huadhënësit. Ky studim zbuloi se ekspozimi si për sa iu përket

aktiveve bankare ishte i përqendruar në 13 huadhënësit kryesorë të Eurozonës. Rreziku më i madh që identifikoi ishte se bankat në hije tërheqën fondet e tyre nga bankat, si depozitat dhe marrëveshjet e riblerjes. Këto përbëjnë 13 për qind të të gjitha detyrimeve të bankave tradicionale ose më shumë për bankat më të mëdha. Po ashtu, BQE-ja ka shpjeguar se ky financim mund të jetë shumë i ndjeshëm ndaj

cilësisë së kredisë së bankave marrëse dhe mund t'i përforcojë presionet e financimit me të cilat përballen bankat nëse qëndrueshmëria e bazave të tyre vihet në dyshim. Nëse një ose një grup i këtyre bankave do të ishte nën presion apo në një situatë të vështirë, ndoshta do të kishte pasoja të konsiderueshme në drejtim të aftësisë së pjesëve të rëndësishme të sektorit për ta menaxhuar likuiditetin dhe rreziqet e tregut.




Bordi i AKP-së merr disa vendime për procesin e privatizimit

PRISHTINË, 31 MAJ - Bordi i Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të Privatizimit ka mbajtur mbledhjen e radhës në të cilën ka marrë vendime për procesin e privatizimit dhe të likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore në përputhje me mandatin e vet ligjor. Bordi i Drejtorëve ka shqyrtuar raportin për monitorimin e planit për adresimin e rekomandimeve të Njesisë së Auditimit të Brendshëm për periudhën 2017-2021 si dhe ka shqyrtuar planin për adresimin e rekomandimeve të Auditimit të Brendshëm për katër auditime që kanë mbuluar periudhën janar 2021 - tetor 2022.

Gjithashtu, Bordi ka shqyrtuar edhe raportet për monitorimin e planeve për adresimin e rekomandimeve të ZKA-së gjatë auditimit të AKP-së dhe Fondeve në Mirëbesim për vitin 2021.

Gjatë kësaj mbledhje Bordi i Drejtorëve u informua në lidhje me procesin e deritashëm të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Përkohshëm të ndërmarrjes shoqërore "Brezovica", me ç'rast komisioni përkatës njoftoi se në fazën e intervistimit do të përfshihen 23 kandidatë nga 44 kandidatë



sa kanë aplikuar në konkurs. Veç kësaj, Bordi dha pëlqimin për bartjen e pronësisë së N.Sh. "Jugopetrol" në emër të Këshillit Gjyqësor për ndërtimin e objektit të ri të Gjykatës Themelore në Pejë në përputhje me vendimin përfundimtar të Qeverisë së Kosovës për shpronësim me numër 20/67 të datës 09 mars 2022, si dhe dha pëlqimin për

bartjen e pronësisë së N.Sh. "Kooperativa Bujqësore Përparimi" (PRN019), në Podujevë në emër të komunës së Podujevës në përputhje me vendimin përfundimtar të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për shpronësim me numër 10/132 të datës 08 mars 2023. Bordi, po ashtu, dha pëlqimin sipas kërkesës së komunës së Ferizajt për

dhënie e pëlqimit për kryerjen e punimeve, rregullimin e segmenteve rrugore (bypass-ve) të përkohshëm të cilat kalojnë përmes disa parcelave në Ferizaj të N. Sh. "Plantacioni i Pemëve". Gjatë takimit Bordi ka shqyrtuar propozimin e Autoritetit të Likuidimit dhe të Menaxhmentit për disa

qiradhënie me tender publik. Bordi, po ashtu, miratoi edhe tri raporte fillestare për inicim të procedurës për shitje me negociim direkt për ekonomi familjare, të cilat do t'u nënshtrohet procedurave të tjera të parapara me legjislacion për t'u finalizuar shitja sipas raportit përfundimtar, i cili do t'i paraqitet Bordit për aprovim.

Në muajin prill, të punësuar me pagë primare në Kosovë, 360 446 persona

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 31 MAJ - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar statistikat administrative të tregut të punës për muajin prill 2023. Këto të dhëna bazohen në të dhënat e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) dhe Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës (APRK). Ky publikim ofron të dhëna për numrin e të punësuarve të kategorizuar sipas: gjinisë, grup-moshës, numrit të të

punësuarve me pagë primare dhe sekondare, përqindjes së të punësuarve sipas aktiviteteve ekonomike, si dhe të dhënat për punëkërkuessit e regjistruar sipas gjinisë dhe grupmoshës. Në muajin prill të punësuar me pagë primare janë regjistruar 360 446 persona, derisa të punësuar me pagë sekondare janë regjistruar 16 966 persona. Punësimi sipas aktiviteteve dhe gjinisë mbi moshën 15-vjeçare ishte më i madh tek administrata publike dhe



mbrojtja, sigurimi i detyrueshëm social (22.8 për qind); tregtia me shumicë dhe pakicë, riparime automjesh dhe motoçikletash (21.7 për qind); prodhimi (11.1 për qind); ndërtimtaria (6.2 për qind); aktivitetet e akomodimit dhe shërbimet e ushqimit (5.4 për qind); aktivitetet financiare dhe të sigurimeve (5.4 për qind) etj. Ndërkaq, punëkërkuessit të regjistruar sipas grupmoshës ishin 29 582 persona, prej tyre 16 029 meshkuj dhe 13 553 femra.

Kur më të dashurit vdesin, ata kurrë nuk largohen



Nga: Anthony SELDON,
edukator, historian dhe
autor i mbi 40 librave /
The GUARDIAN (titulli
original: *A simple truth:
when loved ones die, they
never really go away*)

Nuk jam i sigurt nëse njerëzit vdesin – nëse të vdesësh do të thotë tërheqje, zhdukje apo shuarje. Përkundrazi, besoj se ata jetojnë, në kujtimet e atyre që i njohën dhe i donin, në çdo detaj të jetës sikur të ishin ende gjallë. Në të vërtetë, mund të jenë më të gjallë dhe më reale sesa ata që në tri dimensione janë të gjallë. Mund të kemi edhe biseda më të mira me ta. Kjo Ditë e Nderimit [28 maji] – e krijuar për t'i kujtuar dhe për t'i çmuar ata që nuk janë më me ne – është një shans për t'i sjell në jetë të dashurit tanë të vdekur dhe për t'i paramenduar sërish marrëdhëniet tona me ta. Nuk kemi nevojë të zhytemi në

trishtim. Kur e lejojmë procesin e natyrshëm dhe të nevojshëm të pikëllimit që të kalojë përmes nesh, kjo nuk do të na bëjë të trishtuar. Sepse, depresioni dhe pikëllimi janë gjëra shumë të ndryshme, siç e kuptova unë kur humba gruan time të dashur me të cilën për 34 vjet isha i martuar.

U takuam në Oksfordin e Veriut, në semestrin e verës të vitit 1974, për leximin e parë të Tri motrave të Çehovit. Joanna ishte gjithçka që unë nuk isha: e zgjuar, e sigurt, e ditur dhe e bukur. Si besimtar i dashurisë në shikim të parë, atë ditë nuk u dashurova në të.

Isha shumë i dashuruar në shoqen me të cilën ajo banonte, dhe ne bënim shëtitje të gjata së bashku teksa unë i kërkoja këshilla se si mundem ta josh shoqen e saj më të mirë. Gjithnjë e më pak ishte e interesuar të më jepte këshilla të mira, dhe vura re se disa prej tyre ishin qëllimisht të këqija.

Dy vjet pasi u larguam nga Oksfordi, me një grup shkuam në Firence. Lartë në kodrat toskane, erdhi një moment befasi dhe u bëmë çift. Tre fëmijë dhe shumë lumturi, ndërsa më vonë erdhi diagnoza se ajo kishte kancer të pashërueshëm.

Gjatë pesë vjetëve të gjata të sëmundjes së saj, u afruam më shumë se kurrë. Gjithmonë kemi biseduar me njëri-tjetrin, për çdo ditë në telefon kur nuk ishim pranë njëri-tjetrit, por atëherë, me Joannan në shtëpi, bisedonim personalisht për çdo ditë. S'e kisha idenë se ishte e mundur të isha kaq i afërt me një qenie tjetër njerëzore.

Pasi vdiq në dhjetor të vitit 2016, vazhdova të flisja me të, secilën ditë, sikur të ishte ende e ulur në karrigen e saj të preferuar pranë dritares. Mund ta dëgjoja zërin e saj, dhe ajo mund ta dëgjonte timin. Ishte vërtet ajo? Nuk keni nevojë të besoni në Zot, si unë, për të menduar se mund të

flasim vërtet me ata që janë larguar nga kjo jetë tokësore.


Tashti, shtatë vjet më vonë, dhe i sapomartuar – që në vitin e kaluar, me gruan time të dërguar nga qielli, Sarah – flas më pak me Joannan. Por, e di se ajo është ende aty, e shoh buzëqeshjen e saj të mirëkuptimit, ashtu siç bënte gjithmonë. Ashtu siç do të bënte gjithmonë. Ashtu si prindërit e mi dhe të tjerët që kam dashur. Ata nuk janë të vetmit njerëz me të cilët flas dhe që nuk janë më fizikisht pranë. Në verën e vitit 2021, nga Zvicra eca për në Detin e Veriut. E realizoja ëndrrën e një ushtari të ri të Luftës së Parë Botërore, Alexander Douglas Gillespie, i cili dikur parashikonte rrugën e paqes përgjatë hendekëve që ndanin palët ndërluftuese. Menjëherë pasi e shkroi ëndrrën e tij në një letër drejtuar prindërve të vet, u vra nga zjarri i armikut në ditën e parë të Betejës së Losit; 100 vjet më

vonë e gjeta letrën e tij, letrën e zbehur, por ideja ishte më e nevojshme se kurrë.

Teksa ecja përgjatë një mijë kilometrave të frontit të vjetër perëndimor, shpeshherë flisja me Douglas Gillespien. Më gëzonte kur isha i lodhur, kur më dhembnin këmbët, kur e humbja entuziazmin dhe energjinë. Ecëm së bashku deri në Detin e ftohtë të Veriut. Tash e kam marrë përsipër një shkollë në Sari [Surrey] ku u vra drejtoresha e mrekullueshme Emma Pattison dhe vajza e saj. Teksa e shkruaj këtë për ta nderuar, shpeshherë mendoj se çfarë do të bënte nëse ajo – e jo unë – do ta drejtonte shkollën. Jeta nuk është fare ashtu siç më kanë shtyrë të besoj se është, atëherë kur unë isha i ri. Kam kuptuar se fillon me lindjen dhe se nuk përfundon me vdekjen. Pra, Dita e Nderimit nuk është ditë trishtimi, por e përtëritjes. Dhe, në të vërtetë është festë. /Telegrafi/



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Kosova me pesë boksierë në turneun ndërkombëtar ‘Miroslav Petroviç’

PRISHTINË, 31 MAJ - Federata e Boksit e Kosovës (FboxK) me anë të një njoftimi për medie ka bërë me dije se pesë boksierë do ta përfaqësojnë Kosovën në turneun ndërkombëtar “Miroslav Petroviç”. Kjo do të jetë gara e radhës sipas kalendarit vjetor për FboxK-së, e cila do të zhvillohet më 2 dhe 3 qershor në Kumanovë. Kosova do të

jetë pjesëmarrëse në këtë turne me tre boksierë seniorë dhe dy të rinj. Seniorët do të përfaqësohen nga Gentrit Gashi (kategoria 60 kilogramë), Shpëtim Bajoku (kategoria 67 kilogram) dhe Patriot Behrami (kategoria 71 kilogramë). Në anën tjetër, pjesë e të rinjve janë Benjamin Deva (kategoria 48 kilogramë) dhe Sali Hajdaraj (kategoria 60 kilogramë).


Ekipin e boksierëve kosovarë do ta udhëheqë selektori Besim Brahimi dhe trajneri Mehmet Haxhani. “Këto gara janë të mirëseardhura për boksierët Shpëtim Bajoku dhe Patriot Behrami para garave kualifikuese evropiane për Lojërat Olimpike ‘Parisi 2024’ që organizohen në Krakow (Poloni) në muajin qershor”, thuhet në njoftimin FboxK-së.



Sevilla fiton Ligën e Evropës

BUDAPEST, 31 MAJ - Sevilla është fituese e Ligës së Evropës për sezonin 2022-23. Skuadra spanjolle është konfirmuar si e “pathyeshme” në kompeticionin e dytë më të rëndësishme për klube, duke rrëmbyer për herë të 7-të këtë trofe. Sevilla triumfoi nga ruleta e penalltive, pasi koha e rregullt dhe shtesa u mbyllën në shifrat 1-1. Ashtu siç edhe pritej finalja e Budapestit ishte e barabartë, me të dyja skuadrat që krijuan raste, por dhe ishin shumë të kujdesshme në prapavijë. Roma gjithsesi do të ishte e para që do të gjente rugën e rjetës. Në minutën e 34-të, verdheqkutë arrin që të gjejnë golin me Dybalan, që shënon një

super gol, pas një pasimi magjik nga Mancini nga mesi i fushës. Mbrojtësi i Romës, në fakt do të bëhej protagonist dhe në fillimin e pjesës së dytë, por këtë herë për keq. Në minutën e 55-të, skuadra spanjolle nisi festën, pasi ishte pikërisht Mancini që devijoi topin në portën e tij pas një krosimi të ardhur nga krahu i djathtë. Koha e rregullt më pas nuk do të sillte më asnjë gol, por tensioni dhe ritmi nuk mungon. Sfida shkoi në shtesë, ku edhe atje nuk kishte shumë mundësi për të ndryshuar shifrat. Nga ruleta e penalltive, Sevilla do të triumfonte me 4 penalti të sakta, ndërkohë që te Roma gabuan Ibanez dhe Mancini.



‘Dardanët’ në Prizren i presin Zvicrën dhe Danimarkën

PRISHTINË, 31 MAJ - Përfaqësuesja A e Kosovës prej 19 korrikut deri më 5 gusht do të zhvillojë katër ndeshje në kuadër të parakualifikimeve për FIBA EuroBasket 2025. Kosova është në Grupin H së bashku me Zvicrën dhe Danimarkën. Ndeshjet si vendës basketbollistët e Kosovës për herë të parë do t’i luajnë në qytetin e Prizrenit, ku më 19 korrik e presin Zvicrën, ndërsa më 5 gusht janë nikoqirë të Danimarkës. Së fundi, kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), Arben Fetahu, është pritur në takim nga kryetari i komunës



së Prizrenit, Shaqir Totaj, nga i cili e ka marrë mbështetjen e fuqishme për organizimin e dy

ndeshjeve si nikoqir i Kosovës në palestrën “Sezaï Surroi” në Prizren.

Në vitin e kaluar Federata e Basketbollit e Kosovës në Prizren e ka organizuar FIBA U16 Kampionatin Evropian, Divizioni C, si dhe këtë vit nga data 8 qershor deri më 12 qershor Prizreni e mirëpret turneun ndërkombëtar të FIBA Youth Development Fund (FIBA Europe YDF), projekt ky që për qëllim ka zhvillimin e basketbollistëve/basketbollisteve të rinj. Shtetet të cilat do të jenë pjesëmarrëse në turneun ndërkombëtar të FIBA Europe YDF janë: Kosova U14, Maqedonia e Veriut U14, Bullgaria U14, Turqia U14 si

dhe Rumania U14. Përfaqësuesja A e Kosovës do të bëjë gara në fazën në raundin e tretë të parakualifikimeve për FIBA EuroBasket 2025. Krahas ndeshjeve në shtëpi, Kosova udhëton për t’u takuar me Danimarkën më 26 korrik, kurse me Zvicrën si mysafire do të përballen më 29 korrik. Federata e Basketbollit e Kosovës është e bindur se në ndeshjet si nikoqirë në Prizren, basketbollistët tanë do ta kenë përkrahjen e madhe të adhuruesve të basketbollit për t’i ndihmuar ata në këto dy sfida dhe kështu për të kaluar në raundin tjetër.

Blakçori, largimi i radhës nga Drita

GJILAN, 31 MAJ - Nënkampionia e Kosovës në futboll, Drita, ka ndarë rrugët edhe me një tjetër futbollist. Bëhet fjalë për mbrojtësin e krahut të majtë, Ilir Blakçori. Lajmin e ka konfirmuar vetë mbrojtësi Blakçori, i cili e ka falënderuar klubin gjilanas për bashkëpunimin që

kishin, tifozët “Intelektualët” për përkrahjen si dhe futbollistët. “Kam arritur marrëveshje për ndërprerjen e bashkëpunimit me skuadrën e FC Dritës. Faleminderit qytetit tim të dytë, tifozëve ‘Intelektualët’, kryesisë së klubit, stafit si dhe bashkëlojtarëve të

deritanishëm! Dritës i dëshiroj shumë suksese në sezonin e ri. Faleminderit!”, ka shkruar Blakçori në “Faceboook”. Të martën largimin nga skuadra e Dritës e konfirmoi edhe mesfushori Hamdi Namani, kurse pritet të ketë edhe largime të tjera në ditët e ardhshme.



Thaqi: Për klube vendore nuk e ndërroj Ballkanin

SUHAREKË, 31 MAJ - Një prej futbollistëve më të mirë në skuadrën e Ballkanit, Armend Thaqi, për "lajmi.net" ka folur edhe për të ardhmen e tij. Thaqi ka kontratë me klubin suharekas

deri në fund të edicionit të ardhshëm, kurse ka siguruar se do ta respektojë atë. "Unë me Ballkanin kam kontratë edhe një sezon. Normalisht për gara vendore do ta respektoj

kontratën. Nuk kemi arsye për ta ndryshuar klubin në gara vendore. Jemi kampionë dhe një ekip shumë i fortë. Ndërsa nëse vjen ndonjë ofertë nga ndonjë ligë më lart, secili futbollist

dëshiron të provojë hapa të tjerë", ka thënë Thaqi, i cili pak ditë më parë arriti të stolisej me titullin e dytë me radhë të kampionit në Superligën e Kosovës në futboll me "portokallezintë".



Trajneri i Shqipërisë: Guardiola gjeni, por Interi vdekjeprurës

TRANË, 31 MAJ - Ka fituar tripletën me Barcelonën e Pep Guardiols dhe e ka mbyllur karrierën si lojtar te Manchester City, për të qenë më pas për dy vjet asistent i Roberto Mançinit në stolin e Interit. Sot trajner i Kombëtares së Shqipërisë, Sylvinho do ta ketë të vështirë që mbrëmjen e 10 qershorit ta zgjedhë skuadrën të cilën do të përkrahë, ose të paktën nuk ka preferuar ta zbulojë të preferuarin e tij në mes të Manchester Cityt dhe Interit në deklaratën e bërë për "Gianlucadimarzio.com". "Fatkeqësisht nuk do të shkoj dot në Stamboll, por do të jetë një ndeshje e mrekullueshme mes dy skuadrave që luajnë futboll ndryshe", e nisi fjalën braziliani që po e ndjek sfidën nga televizori, ndërkohë që ka nisur përgatitjet për dy ndeshjet që e presin Shqipërinë në qershor, ato ndaj Moldavisë dhe Ishujve Faroe. Si dikush që ka pasur fatin të luajë dhe të triumfojë në një finale Ligën e Kampionëve, trajneri e di mirë sa i vështirë është rrugëtimi. "Arritja në finalen e Ligës së Kampionëve nuk është diçka që ndodh çdo ditë. Të dyja ekipet kanë bërë një rrugë të çmendur. Ndoshta harrojmë se Interi u kualifikua në një grup ku ishin Bayern Muncheni dhe Barcelona, dy skuadra që fituan kampionatet e tyre përkatëse. Dhe pastaj kaluan një derbi në



gjysmëfinale, me pak fjalë ndeshje aspak të parëndësishme", u shpreh 49-vjeçari, që u ndal edhe në krahasimin mes dy filozofive të lojës, kujtimet me Cityn dhe pritshmëritë për finalen. "Guardiola ka vite që jep leksione futbollit te City dhe çdo sezon shton diçka. Edhe lojtarët janë rritur shumë. Ndërsa Interi është një ekip vdekjeprurës. Mbrohet me 3-5-2, por ka lojtarë të fortë fizikisht për t'i mbyllur hapësirat dhe për të rifilluar me një tranzicion cilësor. Për ta përmbledhur: është një ekip reagues. Jam i bindur se do të jetë e vështirë edhe për Sitin të përballet me ta. Mos të mendojmë se Interi luan vetëm me top të gjatë dhe kundërsulme, jo, ata nisen shumë mirë dhe mund të bëjnë keq", ka shtuar trajneri kuqezi. "Kur përfunduar të pestët pas Tottenhamit më 2009-2010, pra

jashtë Ligës së Kampionëve, presidenti hyri në dhomën e zhveshjes pas ndeshjes së fundit dhe mori fjalën. Ne prisim diçka të fortë, por jo, ai na tha se kishim bërë shumë mirë. Aty kuptova se ai po hidhte themelet e një dinastie fituese. Ne lojtarët ishim të shkatërruar, por e kuptova që ekipi do të bëhej i madh. Tani Cityt i mungon vetëm Liga e Kampionëve, por nuk ka një recetë për ta fituar atë. Ne me Pepin fituam tripletën në Barcelonë, një trajner që na dha shumë në aspektin e ideve. Sot ai punon shumë edhe në fazën mbrojtëse, për mua është një gjeni i futbollit", ka deklaruar Sylvinho. "Thashë që nuk ka truk për ta ngritur trofeun. Çdokush mund të fitojë në 90 minuta, kjo është bukuria e futbollit: luan 11 kundër 11 dhe pjesa tjetër vijon vetë", ka deklaruar Sylvinho.

SHKURT

Guardiola, trajneri më i mirë në Premierë Ligë

Pep Guardiola e ka fituar çmimin e trajnerit më të mirë të sezonit në Premierë Ligë, pasi udhëhoqi Manchester Cityn drejt titullit të tretë radhazi. 52-vjeçari ka mbikëqyrur periudhën më të suksesshme të Cityt në historinë e klubit duke fituar pesë trofe të ligës angleze gjatë kohës së tij në krye. Guardiols trofeu i vetëm që po i mungon është Liga e Kampionëve. Këtë ka mundësi ta fitojë kur City do të përballet me Interin në finalen e këtij sezoni në Stamboll, të shtunën, më 10 qershor. Spanjollit këtë çmim e ka fituar për herë të katërt.

Enrique refuzon ofertën e Napolit

Skuadra kampione e Italisë, Napoli, vazhdon të jetë pa trajner. Pas largimit të Spalletit, drejtuesit kanë nisur kërkimin për teknikun e ri që do ta drejtojë skuadrën por, mesa duket, nuk do të jetë e lehtë për të gjetur të duhurin. Vetë De Laurentis u shpreh se është refuzuar nga Luis Enrique për shkak se ky i fundit kërkon Premierë Ligën, ndërkohë që për Sergio Conceição duhet të paguajë 18 milionë euro klauzolë. Në kushte të tilla, De Laurentis ka kontaktuar edhe trajnerin Marselino Garcia i cili prej një viti është pa punë. Trajneri spanjoll nuk ka qenë pjesë e asnjë skuadre që nga sezoni i shkuar kur largohej nga Bilbao, ndërkohë që edhe ky i fundit ka refuzuar sepse është në bisedime me Nottingham Forestin dhe Olimpik Mareseillen.

15 futbollistë pritet të largohen nga Chelsea

Trajneri Mauricio Pochettino me marrjen e drejtimit të skuadrës duket se po përgatit një revolucion të vërtetë. Sipas "Daily Mail", me ardhjen e strategut argjentinas, 15 futbollistë do të largohen gjatë kësaj vere, pasi nuk janë në planet e tij. Vitin e kaluar blutë e Londrës investuan 600 milionë euro, por sërish mbeten jashtë zonës së kompeticioneve evropiane. Joao Felix pritet të jetë largimi i parë nga Chelsea. "Daily Mail" shton se Pierre-Emerick Aubameyang, Hakim Ziyech, Christian Pulisic, Edouard Mendy dhe Callum Hudson-Odoi me siguri do të largohen nga "Stamford Bridge". Ndoshta edhe Cesar Azpilicueta, Marko Kovaçiq, Conor Gallagher, Trevoh Chalobah, Loftus-Cheek dhe N'Golo Kante. Mund të largohet edhe ish-lojtari i Napolit, Kalidou Koulibaly, ndërsa Denis Zakaria me siguri që do të rikthehet te Juventusit, pasi u mor në formë huazimi.

Neymari dëshiron t'i bashkohet Unitedit

Ylli i Kombëtares së Brazilit dhe skuadrës së Manchester Unitedit, Neymar, po synon një lëvizje drejt Manchester Unitedit. "L'Equipe" raportoi javën e kaluar se Manchester Unitedi ishte në bisedime të avancuara për të nënshkruar me sulmuesin e Paris Saint-Germainit, i cili është gjithnjë e më i hapur për një largim nga kryeqyteti francez. Dëshira e tij për të bërë lëvizjen drejt "Old Trafford" thuhet se ka bërë që Neymari të refuzojë çdo kontakt të mundshëm nga Arabia Saudite. Tani, sipas asaj që ka raportuar "FootMercato", transferimi i brazilianit është i lidhur me mundësinë që Unitedi të bëhet me pronarë nga Katari. Kjo thuhet se mund të lehtësojë një lëvizje të 31-vjeçarit drejt "Djave të Kuq". Nëse dështon një transferim i mundshëm te Manchester Unitedi, Neymari besohet se do të vendosë për të qëndruar në "Parc des Princes".

Alonso vendos rekordin historik në Montekarlo

MADRID, 31 MAJ - Vendi i dytë që Fernando Alonso arriti ditën e diel në pistën e Montekaros është i veçantë për pilotin spanjoll. Dy herë kampioni i botës në Formula 1 bëhet piloti i parë në histori që ngjitet në podiumin e garës së Montekaros me katër makina të ndryshme: Renault, McLaren, Ferrari dhe Aston Martin. Në vitin 2006 ai u ngjiti për herë të parë në podium, duke fituar me Renaultin, ndërkohë që një vit më vonë përsëriti të njëjtin rezultat, por këtë herë duke pilotuar një makinë McLaren. Më pas është ngjitur dy herë në podium me Ferrarin, në vitet 2011 (i dyti) e 2012 (i treti). Pas dhjetë vjetësh, në moshën 41-



vjeçare, Alonso rikthehet në podiumin e Montekaros, këtë herë me Aston Martin. Falë vendit të dytë në këtë garë, Alonso e çon në 103 numrin e podiumeve në karrierën e tij, duke u barazuar me

finlandezin Kimi Raikkonen. Më shumë podiume në karrierë ka Lewis Hamiltoni (192), ndjekur nga Michael Schumacheri (155), Sebastian Vetteli (122) dhe Alain Prost (106).

Mediet spanjolle: Ancelotti edhe një vit trajner i Realit

Carlo Ancelotti do të jetë trajneri i skuadrës së Real Madridit edhe në sezonin tjetër. Lajmin e konfirmon e përditshmja spanjolle "AS", sipas së cilës, është arritur

marrëveshja që trajneri italian ta vijojë drejtimin e "Los Blancos" edhe sezonin e ardhshëm, duke respektuar kontratën. Muajt e fundit ishte përfolur për largimin e tij dhe

mundësinë që Ancelotti ta merrte drejtimin e kombëtares braziliane. Gjithsesi, burime nga klubi madrilen konfirmojnë se Ancelotti po ndërton skuadrën e sezonit të ri, ekip që

do të përforcohet në çdo repart sipas udhëzimeve që po jep trajneri. Sipas "AS", Carlo Ancelotti ka kërkuar dy përforcime në sulm, ndërsa nga një në repartet e tjera. Një nga

sulmuesit që ka kërkuar trajneri është Joselu, ndërsa tjetri do të mësohet më vonë. Gjithsesi, trajneri italian ka vendosur ta respektojë kontratën, duke i shuar ëndrrat e brazilianëve.



SHKURTYRI I MBETURINAVE
 "AMBIENTI" SH.A. PEJË
 Nr. 532
 Data 31.05.23



**NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE "AMBIENTI" SH.A
 LOCAL PUBLIC ENTERPRISE "AMBIENTI" J.S.C
 LOKALNO JAVNO PREDUZEĆE „AMBIENTI“ A.D**

Adresa: Zyrat qendrore Rr. Xhem Sadrija p.n, 30000 PEJË
 Email: krm.ambienti@yahoo.com

Në bazë të nenit 21 të Ligjit numër 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (i publikuar në Gazetën Zyrtare me datë 15.06.2008), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin numër 04/L-111 (i publikuar në Gazetën Zyrtare me datë 30.05.2012), nenit 15 paragrafi 2.2 pika (Dh) të Statutit të NPL "Ambienti" Sh.A., Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve në takimin e mbajtur me datë 13.05.2023, vendosi të shpall ketë:

KONKURS

Pozita: **Zyrtar/e Kryesor Financiar dhe i Thesarit**

Kohëzgjatja e mandatit: 3 (tre) vite – me mundësi vazhdimi
 I përgjigjet: Bordit të Drejtorëve dhe Kryeshefit Ekzekutiv
 Orari i punës: I plote
 Vendi: Pejë

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

Bordi i Drejtorëve dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të njohur të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, si dhe plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2 pikat (d), (f), (j), (k) dhe (l), nenit 17.3 pika (a), dhe (b), detyrimin të dhënies së deklaratës nën betim sipas nenit 17.5 të Ligjit për Ndërmarrje Publike dhe se kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë. Përveç këtyre kushteve të përgjithshme kandidatët duhet të plotësojnë edhe këto kushte të veçanta:

- Kandidati/ja duhet të ketë diplomë universitare me të paktën 240 kredi/ECTS ose master, në ekonomi, juridik, administratë publike, financa publike dhe/ose kontabilitetit. Diplomati nga universitetet e huaja duhet të jenë të nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
- Të ketë së paku 5 vite përvojë në nivel të lartë të menaxhmentit në fushën e administrimit të biznesit, financave korporative, financa, menaxhim i thesarit, banka, konsulencë në biznes, industri ose nga një fushë tjetër e shkencës e cila ka të bëjë me veprimtarinë afariste të NP-së për së paku 5 vite.
- Të ketë njohuri në interpretimin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) në bazë të cilave raporton Ndërmarrja.
- Të ketë integritet të lartë moral e profesional;
- Të ketë aftësi të dëshmuara në menaxhim;
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi;
- Të mos jetë i dënuar ose nën hetime;
- Një program zhvillimor për kompaninë.

Detyrat dhe përgjegjësit kryesore:

- Është përgjegjës për zbatimin e të gjitha dispozitave financiare dhe standardeve të kontabilitetit, ligjet e aplikueshme në Kosovë të cilat rregullojnë çështjet financiare dhe aktet normative të ndërmarrjes;
- Organizon udhëheq dhe kontrollon punën e departamentit financiar;
- Mban përgjegjësi për pagesën e obligimeve financiare në pajtim me rregulloret financiare;
- Mban evidencë dhe dokumentacion të saktë për investimet dhe pagesat e ndërmarrjes;
- Përcjell dispozitat financiare në fuqi dhe literaturën profesionale dhe mban përgjegjësi nëse nuk aplikohen ligjet në fuqi;
- Kujdeset për pasurinë e ndërmarrjes, monitoron punën e komisioneve, kontrollon hyrje -daljet financiare në përgjithësi;
- Përcjell gjendjen financiare në banka dhe bashkëpunon me institucionet bankare dhe organet tjera në interes të ndërmarrjes;
- Përgatit llogaritë periodike dhe përfundimtare;
- Është përgjegjës për përgatitjen e transfereve bankare përkatësisht pagesave me dokumentacion mbështetës dhe siguron KE-në se pagesa është në rregull;
- Harton, zbaton dhe kontrollon zbatimin e procedurave financiare nga vartësit;
- Është përgjegjës të kontrollojë mbajtjen në rregull të arkivit të dokumentacionit të kontabilitetit dhe atij financiar;
- Zhvillon dhe zbaton rregullat e brendshme të kontrollit si dhe udhëzimet dhe procedurat për aktivitete si administrimi i buxhetit, menaxhimi i pasurive dhe detyrimeve dhe mbajtja e llogarive;
- Është përgjegjës për rregullsinë e proceseve në funksionin e kontabilitetit në kompani, përgatit dhe zbaton procedurat e kontabilitetit sipas ligjeve të aplikueshme në Kosovë, si dhe me kompetencë menaxhon resurset financiare të kompanisë brenda ligjeve dhe rregullore të aplikueshme;

- Të përgatis të dhënat e ndërmarrjes për auditim;
- Mbanë përgjegjësi për kryerjen e regjistrimeve dhe barazimeve të pasurisë së Ndërmarrjes;
- Përgatit raportet periodike dhe vjetore të Ndërmarrjes për KE dhe Bordin e Drejtorëve.
- Ushtron kujdes për ecurinë e shpenzimeve të Ndërmarrjes, pagesën e obligimeve Ligjore dhe afarizmin e Ndërmarrjes;
- ZKF i përgjigjet: Bordit të Drejtorëve, kryen edhe punë të tjera, për të cilat autorizohet nga KE

Paga: Në pajtim me politikën e kompensimit të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve.

Procedura e aplikimit:

Aplikacionit duhet bashkangjitur edhe këto dokumente:

- CV-ja (Biografia)
- Letër motivuese
- Dëshmitë mbi kualifikimin profesional (diplomën) – kopje
- Dëshmitë për përvojën e punës - (Kontrata/Vendim) - kopje
- Programi zhvillimor për kompaninë në aspektin e menaxhimit të financave.
- Dëshminë që nuk jeni nën hetime, jo më të vjetër se 6 muaj – origjinale;
- Deklarata nën betim; **(merret brenda ndërmarrjes në kopje fizike para se të dorëzohet aplikacioni)**
- Letërnjoftimi - kopje;

Dokumentacioni origjinal mund të kërkohej të sjellet në interviste.

Konkursi qëndron i hapur 30 ditë kalendarike nga dita e publikimit, duke filluar nga data e shpalljes së konkursit me 01.06.2023 deri më 30.06.2023 ora 16:00.

Dorëzimi i kërkesës dhe dokumentacionit përkatës bëhet tek Sekretaria e Kompanisë në zarf të mbyllur me shënim: "Për pozitën: Zyrtar kryesor Financiar dhe i Thesarit i NPL "Ambienti" Sh.a. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim.

Kërkesat-Aplikacionet e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen.

Kërkesat-Aplikacionet e dërguara me poste brenda afatit do të pranohen deri në tre dite pas përfundimit të konkursit.

Kandidatët me dokumentacion të pa-kompletuar, të pa-plotësuar dhe joadekuat do të refuzohen. Vetëm kandidatët e përzgjedhur që i plotësojnë kushtet do të ftohen në intervistë.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Getuar Hasani nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Jozefina Gjidoda shpall të pavlefshme dëftesën e plotë shfmu "Dëshmorët Lleshi" Doblbare KK Gjakovë.

- Bardha Stublla nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. III të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Diellza Mulla Hasani nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Universitetit "Fehmi Agani" Gjakovë me nr. 377 programi Infermieri.

- Skin Sers "SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330478588.

- Besart Myftari B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb 811937046.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA HALAL FOOD PASHTETË PULË

gluten free



100% mish pulë



cilësi e garantuar

pa konservues